



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 31.01.2014
Nr. 0207-76

PËR: **Begzad Sinani**, Kryetar i Komunës së Kamenicës
Bajram Dërmaku, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës

LËNDA: **KËRKESË PËR RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË KAMENICËS, Nr. 01-1481, të pranuar me datën 17.01.2014.**

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit me Nr. 01-1481, të datës 10.01.2014, të Kuvendit të Komunës së Kamenicës, konstaton se:

- Vendimi me Nr. 01-1481 për zgjedhjen e zëvendës-kryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete në Komunën e Kamenicës, është në kundërshtim me legjislacionin për vetëqeverisje lokale, përkatësisht nenin 54.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, i cili e përcakton qartë se në komunat ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komuniteteve jo shumicë, posti i zëvendës-kryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete rezervohet për përfaqësuesit e këtyre komuniteteve.
- Bazuar në regjistrimin e popullsisë 2011 dhe vlerësimin e popullsisë të vitit 2012 të bërë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, komuna e Kamenicës ka më pak se 10 % të komuniteteve jo-shumicë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 81 pika 4 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale *kërkon* nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës që të ndërmarrin veprime konkrete që në afat prej 30 ditësh të bëj rishqyrtimin e Vendimit nr. 01-1481, të Kuvendit të Komunës së Kamenicës.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve në MAPL
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 31.01.2014
br. 0207-76

Za: Begzad Sinani, Gradonačelnik opštine Kamenica
Bajram Dërmaku, Predsedavajući Skupštine opštine Kamenica

Predmet: Zahtev o ponovnom razmatranju odluke Skupštine opštine Kamenica
br. 01-1481, primljeno dana 17.01.2014.

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave , u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom br. 03/L-040,o lokalnoj samoupravi dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i Ministarstva , nakon razmatranja zakonitosti odluke br. 01-1481, dana 10.01.2014, Skupštine opštine Kamenica , konstatuje da :

- Odluka br. 01-1481 o izboru zamenika predsedavajućeg Skupštine opštine za zajednice u opštini Kamenica je u suprotnosti sa zakonom o lokalnoj samoupravi , tačnije člana 54.1 zakona o lokalnoj samoupravi br. 03/L-040, koji jasno određuje da u opštinama gde najmanje 10% građana pripadaju ne većinskoj zajednici , položaj zamenika predsedavajućeg Skupštine opštine za zajednice se rezervuje za predstavnika ovih zajednica .
- Prema popisu stanovništva 2011 godine i procenjivanja stanovništva 2012 godine ,izvršeno od strane Agencije za statistiku Kosova , opština Kamenica ima manje od 10 %ne većinske zajednice.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave , na osmovu člana 81 tačka 4 zakona o lokalnoj samoupravi *traži od strane Skupštine opštine Kamenica* da preduzme konkretne akcije u roku od 30 dana da izvrši ponovno razmatranje odluke br. 01-1481, Skupštine opštine Kamenica .

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a

Kopija: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PER QERIMET E KOMUNES
QENDRA ZA BELEGU GRADINA

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



KOMUNA E KAMENICËS
KUVENDI I KOMUNËS
01.Nr. _____, Më 10.01.2014

Siv.	01	Nr.	1481
U.		Dr.	
Nr. i faq.	1	Data	12/d
Br. str.		Detur	
KAMENICË/A 2014			

Në bazë të nenit 54, pikat 54.1 dhe 54.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji nr.03/L-040 dhe nenit 51 pikat 51.1, 51.2, 51.3 dhe 51.4 të Statutit të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 10.01.2014, mori

V E N D I M PËR ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR KOMUNITETE

I

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 10.01.2014, miratoi Vendimin për zgjedhjen e z. **Dijana Nikoliq** zëvendës kryesuese e Kuvendit të Komunës për komunitete.

II

Detyrat dhe përgjegjësitë e zëvendës kryesueses së Kuvendit të Komunës për komunitete janë të përcaktuara me nenin 54 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 51 të Statutit të Komunës së Kamenicës që kanë të bëjnë me promovimin dhe afirmimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve jo shumicë të cilat trajtohen edhe në mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

III

Zëvendës kryesuesja e Kuvendit të Komunës për komunitete zgjidhet për një mandat të njëjtë sikurse anëtarët e kuvendit.

IV

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës.

V

Me Vendimin të njoftohen: z. **Dijana Nikoliq**, Kryetari, Zyra e Personelit, Zyra Ligjore, Shërbimi Profesional i Kuvendit dhe Qendra për Shërbime të Qytetarëve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Bajram Dervaka

